



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2295/5 prot

Datë 05.10.2023

V E N D I M

K.P.P. 992/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.10.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-75710-07-21-2023 me objekt “*Loti 1 Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave*” me fond limit: 15,990,600.0 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK me NIPT L01314031G dhe adresë: Tiranë, Vaqarr, Rruga e Kavajës, ndërtesa 2 katëshe, kati 2, km 6, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara me adresë: Blv “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.07.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF- 75710-07-21-2023 me objekt “Loti 1 ‘Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave’” me fond limit: 15,990,600.0 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezultojn, se me datë 14.08.2023 është zhvilluar procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezultojn se në datën 23.08.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “Vilnik Motors” SHPK	9,738,900 lekë	skualifikuar
2. “Servis Auto 2000” SHPK	9,963,100 lekë	kualifikuar
3. “Alstezo” SHA	10,960,000 lekë	kualifikuar
4. “Kadiu” SHPK	13,748,108 lekë	kualifikuar

Operatori ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK rezultojn i skualifikuar për arsye se:

• *Operatori nuk plotëson pikën 2 të Seksionit 2.2.Kapaciteti Financiar në Kërkesat e Veçanta për Kualifikim , ku përcaktohet se “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore”. Për këtë pikë operatori nuk paraqiti bilance të certifikuara pranë tatimeve për vitin 2022 në kundërshtim me kërkesën ku përcaktohet qartë që kërkohen 3 bilance të certifikuara. Për këtë arsye në mbështetje të paragrafit të fundit të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim ”Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”, KVO vendos ta skualifikojë OE dhe të refuzojë ofertën e tij.*

II.4 Në datë 15.09.2023 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftimit të Fituesit Paraprak.

II.5.Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezultojn, se në datën 19.09.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër 2295/2023 prot., datë 19.09.2023 e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2295/2 datë 20.09.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues nga procedura e prokurimit.

II.7 Me shkresën me nr. 2295/3 prot., datë 02.10.2023 me lëndë “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik në përputhje me nenin 114 të LPP-së, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë brenda ditës së nesërme nga marrja e shkresës, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 1251/4 prot., datë 29.09.2023 protokolluar me tonën me nr. 2295/4 prot., datë 05.10.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës. Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

“[...] Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet detyrimi i operatorëve ekonomikë që të dërgojnë ankesën njëkohësisht në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik.

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor verifikoi në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik nëse është paraqitur ankesa pranë këtij institucioni, sipas parashikimeve të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Nga verifikimi në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik rezulton se operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK ka paraqitur ankesë pranë këtij institucioni me nr. prot. 2295/2023 datë 19.09.2023..

Pasi u shqyrtuan të gjitha dokumentet e vëna në dispozicion si: dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimi të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ankimuesi dhe pretendimet e parashtruara në ankesë lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, sipas përcaktimeve të nenit 114 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 1, paragrafi i dytë, në të cilin parashikohet se : “Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të

tyre.”, si dhe VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 100, pika 2, paragrafi i dytë, në të cilin parashikohet se: Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113, të LPP-së, për paraqitjen e argumenteve të tyre”, ju komunikojmë vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK ka ankimuar skualifikimin e ofertës të së tij, duke përshkruar këto rrethana dhe fakte: “Në datë 14.08.2023 ora 11:00 është zhvilluar “Procedurë e hapur” “marrëveshje kuadër” Loti 1 me afat 24 muaj “Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave” me fond limit 15.990.600 lekë pa TVSH”, me arsyetimin: Operatori nuk plotëson pikën 2 të seksionit 2.2 kapaciteti financiar në kërkesat e veçanta të kualifikimit ku përcaktohet se operatorët ekonomikë financiar duhet të paraqesin kopje të certifikuar të bilanceve të viteve 2020-2021-2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në këtë pikë operatori nuk paraqiti bilancet e certifikuara nga tatimet të vitit 2022 një kundërshtim me kërkesën ku përcaktohet qartë që kërkohen 3 bilance të certifikuara, Për këtë arsye në mbështetje të paragrafit të fundit të kërkesat e veçanta për kualifikim raste e mosparaqitjes së një dokumenti ose dokument false dhe të pasakta konsiderohen kushte për skualifikim, KVO vendos ta skualifikoje OE dhe ta refuzojë ofertën e tij.

Sa më sipër nuk jemi dakort me vendimin e KVO pasi skualifikimi jonë është i padrejtë dhe në kundërshtim të LPP dhe VKM dhe i drejtohemi AK dhe KPP për të na dhënë të drejtë të ankimit tonë. Konkretisht e argumentojmë si më poshtë.

Kvo për të bërë një vlerësim sa më korrekt të pjesëmarrësve në një procedurë prokurimi mundet të kërkonte sqarime me shkrim ose email ose të bënte verifikime e saj në institucionet në lidhje me vërtetësinë origjinalitetin rregullsinë e çdo dokumenti të paraqitur nga OE pjesëmarrës në procedurë prokurimi.

KVO mund ta përfshinte këtë mangësi të konstatuar tek devijimet e vogla bazuar tek neni 92 pika 3 shqyrtimit të ofertave.

Për sa më lart kërkojmë nga KSHA e autoritetit të konsiderohet lapsus i konstatuar për bilancin e dorëzuar të vitit 2022 duke bërë rivlerësimin e kësaj procedurë dhe duke na dhënë të drejtën për vazhdimësinë me hapat e mëtejshme të saj”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka bërë vlerësimin si vijon:

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT/NUIS	Vlera e ofertës, lekë (pa TVSH)	Statusi LOT 1
1	“Vilnik Motors” SH.P.K	L01314031G	9,738,900	refuzuar
2	“Servis Auto” SH.P.K	K31523078F	9,963,100	Kualifikuar i pari
3	“Alstezo” SH.A	J63208420N	10,960,000	Kualifikuar i dyti
4	“Kadiu” SH.A	J61817045K	13,748,108	Kualifikuar i treti

KVO ka skualifikuar operatorin ekonomik “Vilnik Motors” SHPK me arsyetimin si vijon: “Operatori nuk plotëson pikën 2 të Seksionit 2.2.Kapaciteti Financiar në Kërkesat e Veçanta për Kualifikim , ku përcaktohet se “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore”. Për këtë pikë operatori nuk paraqiti bilance të certifikuara pranë tatimeve për vitin 2022 në kundërshtim me kërkesën ku përcaktohet qartë që kërkohen 3 bilance të certifikuara. Për këtë arsye në mbështetje të paragrafit të fundit të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim ”Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”, KVO vendos ta skualifikojë OE dhe të refuzojë ofertën e tij”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi dokumentet e tenderit, procesverbalin datë “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave “ “Procedurë e hapur” Marrëveshje kuadër” me afat 2 (vjet) me objekt “Shërbim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave” me fond limit 15.990.600 lekë pa TVSH, me nr. REF-75710-07-21-2023, me datë publikimi të njoftimit të fituesit në SPE, datë 15.09.2023 dokumentacionin e dorëzuar në SPE si dhe pretendimet e parashtruara në ankesë nga operatori ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK dhe konstatoi:

Në pikën 2 të seksionit 2.2 “Kapaciteti financiar”, në kriteret e veçanta të kualifikimit, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit është përcaktuar: “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”

KSHA pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në sistem nga ofertuesi “Vilnik Motors” SHPK konstatoi se ky ofertues në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.2 në

kriteret e veçanta të kualifikimit në dokumentet e tenderit ka dorëzuar kopje të bilanceve të viteve 2020, 2021 dhe 2022. Konstatohet se bilanci i periudhës 2022 nuk është i shoqëruar me vërtetimin e drejtorisë tatimore përkatëse.

Ankimuesi ka shoqëruar ankesën objekt shqyrtimi me vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve me nr. 1101 prot., datë 23.08.2023 në të cilin citohet: “.....ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor për vitin:

- **2022, dorëzuar elektronikisht pranë drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë më datë 29.03.2023**

Në nenin 2 “Qëllimi”, ligji 162/2020 citohet:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në pikën 3, të nenit 92 “Shqyrtimi i ofertave”, ligji 162/2020 citohet:

Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Referuar,

- Dokumentacionit bashkëlidhur ankesës nga ku rezulton se bilanci i periudhës tatimore 2022 është dorëzuar pranë administratës tatimore para momentit të hapjes së ofertave, fakt i cili konfirmohet nga autoriteti tatimor përkatës,
- Ofertës së ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, si dhe
- Bazës ligjore të mësipërme

KSHA e konsideron të përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2 të seksionit 2.2. “Kapaciteti financiar”, në kriteret e veçanta të kualifikimit, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Vilnik Motors” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave,

Vendosi

- 1. Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “VILNIK MOTORS” SHPK për procedurën e prokurimit Procedurë e hapur” Marrëveshje kuadër” “Riparim dhe mirëmbajtje Automjetesh për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave” Loti 1 me afat 24 muaj me fond limit 15.990.600 lekë pa TVSH, me nr. REF-75710-07-21-2023, me datë publikimi të njoftimit të fituesit në SPE 15.09.2023[...].”*

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ nuk rezulton, të jenë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 1251/4 prot., datë 29.09.2023 protokolluar me tonën me nr. 2295/4 prot., datë 05.10.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors”

SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës. Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

“[...] Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet detyrimi i operatorëve ekonomikë që të dërgojnë ankesën njëkohësisht në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik.

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor verifikoi në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik nëse është paraqitur ankesa pranë këtij institucioni, sipas parashikimeve të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Nga verifikimi në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik rezulton se operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK ka paraqitur ankesë pranë këtij institucioni me nr. prot. 2295/2023 datë 19.09.2023..

Pasi u shqyrtuan të gjitha dokumentet e vëna në dispozicion si: dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimi të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ankimuesi dhe pretendimet e parashtruara në ankesë lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, sipas përcaktimeve të nenit 114 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 1, paragrafi i dytë, në të cilin parashikohet se : “Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.”, si dhe VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 100, pika 2, paragrafi i dytë, në të cilin parashikohet se: Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113, të LPP-së, për paraqitjen e argumenteve të tyre”, ju komunikojmë vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, si më poshtë:

1.Operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK ka ankimuar skualifikimin e ofertës të së tij, duke përshkruar këto rrethana dhe fakte: “Në datë 14.08.2023 ora 11:00 është zhvilluar “Procedurë e hapur” “marrëveshje kuadër” Loti 1 me afat 24 muaj “Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave” me fond limit 15.990.600 lekë pa TVSH”, me arsyetimin: Operatori nuk plotëson pikën 2 të seksionit 2.2 kapaciteti financiar në kërkesat e

veçanta të kualifikimit ku përcaktohet se operatorët ekonomikë financiar duhet të paraqesin kopje të certifikuar të bilanceve të viteve 2020-2021-2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në këtë pikë operatori nuk paraqiti bilancet e certifikuara nga tatimet të vitit 2022 një kundërshtim me kërkesën ku përcaktohet qartë që kërkohen 3 bilance të certifikuara, Për këtë arsye në mbështetje të paragrafit të fundit të kërkesat e veçanta për kualifikim raste e mosparaqitjes së një dokumenti ose dokument false dhe të pasakta konsiderohen kushte për skualifikim, KVO vendos ta skualifikoje OE dhe ta refuzojë ofertën e tij.

Sa më sipër nuk jemi dakord me vendimin e KVO pasi skualifikimi jonë është i padrejtë dhe në kundërshtim të LPP dhe VKM dhe i drejtohem AK dhe KPP për të na dhënë të drejtë të ankimit tonë. Konkretisht e argumentojmë si më poshtë.

Kvo për të bërë një vlerësim sa më korrekt të pjesëmarrësve në një procedurë prokurimi mundet të kërkonte sqarime me shkrim ose email ose të bënte verifikimet e saj në institucionet në lidhje me vërtetësinë origjinalitetin rregullsinë e çdo dokumenti të paraqitur nga OE pjesëmarrës në procedurë prokurimi.

KVO mund ta përfshinte këtë mangësi të konstatuar tek devijimet e vogla bazuar tek neni 92 pika 3 shqyrtimit të ofertave.

Për sa më lart kërkojmë nga KSHA e autoritetit të konsiderohet lapsus i konstatuar për bilancin e dorëzuar të vitit 2022 duke bërë rivlerësimin e kësaj procedurë dhe duke na dhënë të drejtën për vazhdimësinë me hapat e mëtejshme të saj”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka bërë vlerësimin si vijon:

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT/NUIS	Vlera e ofertës, lekë (pa TVSH)	Statusi LOT 1
1	“Vilnik Motors” SH.P.K	L01314031G	9,738,900	refuzuar
2	“Servis Auto” SH.P.K	K31523078F	9,963,100	Kualifikuar i pari
3	“Alstezo” SH.A	J63208420N	10,960,000	Kualifikuar i dyti
4	“Kadiu” SH.A	J61817045K	13,748,108	Kualifikuar i treti

KVO ka skualifikuar operatorin ekonomik “Vilnik Motprs” SHPK me arsyetimin si vijon: “Operatori nuk plotëson pikën 2 të Seksionit 2.2.Kapaciteti Financiar në Kërkesat e Veçanta për Kualifikim , ku përcaktohet se “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore”. Për këtë pikë operatori nuk paraqiti bilance të certifikuara pranë tatimeve për vitin 2022 në

kundërshtim me kërkesën ku përcaktohet qartë që kërkojnë 3 bilance të certifikuar. Për këtë arsye në mbështetje të paragrafit të fundit të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim "Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim", KVO vendos ta skualifikojë OE dhe të refuzojë ofertën e tij".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi dokumentet e tenderit, procesverbalin datë "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave " "Procedurë e hapur" Marrëveshje kuadër" me afat 2 (vjet) me objekt "Shërbim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave" me fond limit 15.990.600 lekë pa TVSH, me nr. REF-75710-07-21-2023, me datë publikimi të njoftimit të fituesit në SPE, datë 15.09.2023 dokumentacionin e dorëzuar në SPE si dhe pretendimet e parashtruara në ankesë nga operatori ekonomik ankimues "Vilnik Motors" SHPK dhe konstatoi:

Në pikën 2 të seksionit 2.2 "Kapaciteti financiar", në kriteret e veçanta të kualifikimit, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit është përcaktuar: "Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuar të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit."

KSHA pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në sistem nga ofertuesi "Vilnik Motors" SHPK konstatoi se ky ofertues në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.2 në kriteret e veçanta të kualifikimit në dokumentet e tenderit ka dorëzuar kopje të bilanceve të viteve 2020, 2021 dhe 2022. Konstatohet se bilanci i periudhës 2022 nuk është i shoqëruar me vërtetimin e drejtorisë tatimore përkatëse.

Ankimuesi ka shoqëruar ankesën objekt shqyrtimi me vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve me nr. 1101 prot., datë 23.08.2023 në të cilin citohet: ".....ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj, në sistemin informatik tatimor për vitin:

- **2022, dorëzuar elektronikisht pranë drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë më datë 29.03.2023**

Në nenin 2 "Qëllimi", ligji 162/2020 citohet:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në pikën 3, të nenit 92 “Shqyrtimi i ofertave”, ligji 162/2020 citohet:

Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Referuar,

- Dokumentacionit bashkëlidhur ankesës nga ku rezulton se bilanci i periudhës tatimore 2022 është dorëzuar pranë administratës tatimore para momentit të hapjes së ofertave, fakt i cili konfirmohet nga autoriteti tatimor përkatës,*
- Ofertës së ankimesit në këtë procedurë prokurimi, si dhe*
- Bazës ligjore të mësipërme*

KSHA e konsideron të përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2 të seksionit 2.2. “Kapaciteti financiar”, në kriteret e veçanta të kualifikimit, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimesit “Vilnik Motors” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave,

Vendosi

- 2. Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “VILNIK MOTORS” SHPK për procedurën e prokurimit Procedurë e hapur” Marrëveshje kuadër” “Riparim dhe mirëmbajtje Automjetesh për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave” Loti 1 me afat 24 muaj me fond limit 15.990.600 lekë pa TVSH, me nr. REF-75710-07-21-2023, me datë publikimi të njoftimit të fituesit në SPE 15.09.2023[...].*

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe për këtë fakt, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF- 75710-07-21-2023 me objekt “Loti I ‘Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave’” me fond limit: 15,990,600.0 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri